

inspektimi apo studimi. Avokati i Popullit në këto raste mund të marrë takim, të bisedojë në mënyrë konfidenciale e pa praninë e personave zyrtarë me cilindo person që ndodhet apo mbahet në këto mjedise”.

Qëllimi i inspektimit ishte zbatimi i rekomandimeve të lëna nga Avokati i Popullit në vitin 2017 si dhe gjendja aktuale.

Ju bëjmë më dije se më datë 24.11.2017 është kryer inspektim në Shtëpinë e të Moshuarve në Kavajë. Për problemet e konstatuara ju jemi drejtuar me rekomandime për marrjen e masave për:

1. Shtim në organikë me: roje objekti, psikiatër, mjek me kohë të plotë;
2. Vendosjen e një automjeti;
3. Shtim në buxhet lidhur me mirëmbajtjen e objektit ose të shihet mundësia për transferim në një godinë tjetër të përshtatshme;
4. Trajnimi i të gjithë stafit për përdorimin e mjeteve kundër zjarreve;
5. Ngritjen e një grupi pune për të grumbulluar të gjithë personat me probleme të rënda shëndetësore në një qendër zhvillimi;
6. Rritjen e kuotës ushqimore ditore, minimalisht në 350 lekë;
7. Pas verifikimeve përkatëse, të shihej mundësia për gjetjen e një zgjidhje për të arritur në kuotën e 6000 lekëve në muaj për ata të moshuar, të cilët kanë masa të ulëta të pensioneve të pleqërisë.

Në përgjigje të rekomandimeve të sipërcituara, nga ana e Shërbimit Social Shtetëror informohemi se:

- *Për rekomandimin nr.1*, organika e kësaj qendre është miratuar me Urdhër të Kryeministrit nr.43 datë 17.08.2016. Bashkia Kavajë ka tagrin ligjor për të plotësuar organikën me psikiatër. Për mjekun me kohë të plotë, të gjitha ISHP-të janë plotësuar në strukturën e tyre me mjek sipas VKM nr.11 datë 14.01.2015. Vizitat mjekësore të moshuarit i bëjnë në klinikat e lagjes ku kanë të hapura kartelat mjekësore.
- *Për rekomandimin nr.2*, IPSH-të nuk kanë mjete bazuar në ligjin nr.10160 datë 15.10.2009.
- *Për rekomandimin nr.3*, Shtëpia e të Moshuarve është në varësinë e Bashkisë Kavajë, e cila mund të marrë masa për një veprim të tillë. Ndërsa lidhur me fondet, është vetë institucioni që fondin duhet ta ndajë në zëra sipas nevojave.
- *Për rekomandimin 4*, vetë institucioni duhet të operojë duke i kërkuar MKZ-së të trajnojë stafin.
- *Për rekomandimin nr.5*, në qendrat e zhvillimit pranohen persona me aftësi të kufizuar deri në moshën 21 vjeç. Të moshuarit me probleme të shëndetit mendor trajtohen nga ana e mjekut dhe ekipit multidisiplinar të institucionit me terapi të veçanta mjekësore dhe sociale.
- *Për rekomandimin nr.6*, SHSSH-ja i ka derguar ish-MMSR-së propozim mbi indeksimin e kuotës ushqimore për përfituesit e IPSH, me shkresën nr. 1282 datë 05.07.2017.

- *Për rekomandimin nr.7, kjo pagesë është mbështetur në VKM nr.114 datë 31.01.2007 “Për përcaktimin e masës së kontributeve të personave, që vendosen në institucionet rezidenciale publike, të shërbimit të përkujdesit shoqëror”.*

Ndërsa, nga ana e Kryetarit të Bashkisë Kavajë, informohemi se:

- *Për rekomandimet nr.1 dhe 2, Bashkia Kavajë ndihmon me burime njerëzore, pas miratimit të fondit nga MSHMS-së, për strukturën e kësaj qendre. Kjo bashki i ka fondet e limituara dhe të pamjaftueshme, me gjithë dëshirën për të ndikuar sado pak në lehtësimin e kushteve të jetesës për të moshuarit e kësaj qendre.*
- *Për rekomandimet nr.6 dhe 7, është detyrë e MSHMS-së për të bërë të mundur realizimin e këtyre rekomandimeve.*
- *Për rekomandimin nr.3, Bashkia ka ndërhyrë me mundësitë e saj për izolimin e tarracës.*

Lidhur me zbatimin e rekomandimeve, rezultoi se:

1.Rekomandimi për shtim në organikë me: roje objekti, psikiatër, mjek me kohë të plotë, nuk ishte realizuar. Duke qenë se këto pozicione nuk janë të pasqyruara në organigramën e Shtëpisë së të Moshuarve Kavajë, nga ana e drejtuesit të kësaj qendre është bërë kërkesë në Bashkinë Kavajë, por nuk është kthyer përgjigje.

2. Rekomandimi për vendosjen e një automjeti, nuk është realizuar. Edhe për këtë çështje është bërë kërkesë, ndërkohë që nga ana e drejtuesit të qendrës, po shihet mundësia e realizimit të këtij rekomandimi me anë të donacioneve.

3.Rekomandimi për shtim në buxhet lidhur me mirëmbajtjen e objektit ose të shihej mundësia për transferim në një godinë tjetër të përshtatshme, nuk ishte realizuar.

4.Rekomandimi për trajnimin e të gjithë stafit për përdorimin e mjeteve kundër zjarreve, ishte realizuar

5.Rekomandimi për rritjen e kuotës ushqimore ditore, ishte realizuar, kuota në vlerën e 400 lekëve në ditë.

Nga inspektimi i kryer rezultoi si më poshtë:

Në këtë Shtëpi të Moshuarish trajtohen të moshuar mbi 60 vjeç, nga të cilët 15 të moshuar janë me probleme të rënda shëndetësore. Kapaciteti i përfituesve është 65 persona. Aktualisht strehohen 52 të moshuar, por me vendim Komisionit të Pranimit në Shtëpitë e të Moshuarve pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror, janë caktuar 7 të moshuar. Ishin sistemuar 3 të moshuar dhe pritej që të vinin edhe 4 të moshuarit e tjerë.

Përfitues të pensionit të pleqërisë ishin 44 të moshuar, të cilët nuk paraqitën ankesa ndaj stafit për këtë shërbim. Plani individual për çdo të moshuar mbahej në zyrën e infermiereve.

Personeli i kësaj qendre përbëhet nga 23 punonjës, të cilët kishin dosjet e tyre personale me kualifikimet përkatëse, fotokopje të të cilave dërgohen pranë Bashkisë Kavajë. Përshkrimi i punës së tyre ishte i përcaktuar në Rregulloren e Brendshme të institucionit. Vlerësimi i punës për personelin, bëhet një herë në vit.

Shërbimi mjekësor realizohet nga një mjek me kohë të pjesshme dhe infermieret. Lidhur me vizitat e nevojshme mjekësore, ato përcaktohen nga mjeku, i cili i adreson tek mjeku specialist.

Ilaçet me rimbursim u jepen rregullisht të moshuarve. Nëse duan të marrin suplemente, të moshuarit i blejnë vetë, me shpenzimet e tyre.

Për ata të moshuar, të cilët paraqesin probleme shëndetësore, transportimi për në spital bëhet nga vetë drejtuesi i qendrës, i shoqëruar edhe nga pjesëtarë të stafit. Ditën e inspektimit në këtë qendër, Drejtori dhe shefja e financës kanë shoqëruar të moshuarin H.Z për një operim në Spitalin Francez, Tiranë. Automjeti ishte siguruar privatisht nga vetë drejtuesi i Qendrës, ndërsa operimi do të kryhej falas, falë punës së bërë nga stafi i kësaj qendre.

Kuota ushqimore ditore për çdo të moshuar aktualisht është 400 lekë. Kampionët e ushqimeve ruhen në frigorifer. Merret mendimi i përfituesve për përcaktimin e menisë së ushqimit dhe vakteve të ngrënies.

Furnizimi me artikuj hotelorikë bëhet rregullisht, me tenderime nga fondet e qendrës. Furnizimi me dyshekë ishte mundësuar nga Banka "Societe Generale Albania". Në çdo dhomë kishte dekoder.

Mjetet për shmangien e rreziqeve që mund të vijnë nga rastet e emergjencave civile, ishin të vendosura në vende të veçanta në çdo kat.

Sistemi i ngrohjes dhe ftohjes vijon të realizohet me ngrohëse me korent. Në çdo dhomë kishte nga një ngrohëse. Çdo mbrëmje kujdestarja ka për detyrë të kryejë kontrollin e tyre, me qëllim evitimin e ndonjë avarie.

Kutia e ankesave hapet një herë në vit nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, Tiranë, pasi nuk ka ankesa. Te moshuarit ankohen vetë, jo me shkrim. Çelësi mbahet në atë drejtori dhe një përfaqësues i saj, së bashku me punonjësen sociale të Bashkisë Kavajë hapin kutinë e ankesave, në prezencë të një të moshuari.

Organizohen aktivitete të ndryshme, festa fetare, festa zyrtare, ditëlindje, shkojnë në plazh gjatë periudhës së verës, në piknik etj. Të moshuarit ndjekin ritet fetare. Kishte një libër, ku pasqyroheshim aktivitetet e organizuara.

Që nga vitit 2003, një grup nga Kisha Kristiane, Durrës, çdo të mërkurë, vijnë për të vizituar dhe biseduar me të moshuarit, për t'i inkurajuar dhe për tu gjendur pranë tyre.

Monitorimi i standardeve kryhet nga Bashkia Kavajë, Shërbimi Social Shtetëror, Drejtoria e Higjienës në Kavajë, etj.

Nga takimi me të moshuarit e qendrës, ata shprehën konsideratën ndaj Drejtuesit të institucionit dhe stafit dhe nuk paraqitën ankesa ndaj tyre. Ishim shumë të kënaqur me shërbimet ndaj tyre.

Gjatë këtij inspektimi u konstatuan këto problematika:

1. Nuk ka psikiatër, i domosdoshëm për të moshuarit.
2. Meqë të moshuarit kanë shumë probleme shëndetësore, duhet që të jetë prezent mjeku me kohë të plotë.
3. Një problematikë që haset jo vetëm në këtë institucion, por në të gjitha qendrat e përkujdesjes sociale, është çështja e shërbimit dentar. Ky shërbim mbulohet nga vetë të moshuarit. Do të sugjerohet që një pjesë e këtij shërbimi të rimbursohet nga shteti.
4. Në këtë institucion, strehohen të moshuar, të cilët janë me probleme të rënda shëndetësore, gjë që bëhet pengesë për një jetesë normale të të moshuarve.
5. Një problem shqetësues që ende ka mbetur pa zgjidhje, është mungesa e makinës dhe e shoferit.
6. Nuk ka roje objekti. Dera e jashtme mbyllet me dryn dhe monitorimi bëhet nga stafi dhe kamerat e sigurisë. Aktualisht, vetë drejtuesi i qendrës po lobon për zgjidhjen e kësaj çështje.
7. Vendi mbi të cilin është ndërtuar Shtëpia e të Moshuarve Kavajë, është me probleme permanente lagështire, gjë që ndikon drejtpërsëdrejti në shëndetin e të gjithë personave që strehohen në këtë institucion dhe jo vetëm. Prezenca e lagështirës kërkon gjithmonë ristrukturim të ambjentëve të godinës edhe pas përfundimit të saj, pasi nuk mjafton vetëm lyerja. Kjo do të ndikonte edhe në buxhet, në një kohë që ai fond mund të përdoret për zëra të tjera.
8. Nuk është trajnuar stafi nga Shërbimi Social Shtetëror, Drejtoria Rajonale e SHSSH, Tiranë, Bashkia Kavajë për standartet e shërbimit social. Trajnimet janë shumë të pakta.

Sa më lart, në kuadrin e decentralizimit të shërbimeve shoqërore, po ju drejtohem me rekomandime si Bashkisë Gjirokastër ashtu dhe Shërbimit Social Shtetëror për një bashkërendim të punës, me qëllim ofrimin e një shërbimi sa më cilësor dhe për të realizuar standartet e shërbimeve për një jetesë me dinjitet të përfituesve, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*,

REKOMANDOJMË

Marrjen e masave për :

1. Rikonstrukisonin e plotë të godinës.
2. Shtim në organikë me: kujdestarë, psikiatër, mjek me kohë të plotë.
3. Vendosjen e një automjeti.
4. Trajnim periodik të të gjithë stafit.
5. Ngritjen e një qendre socio-sanitare, ku të trajtohen me përkujdesje të moshuarit me probleme të rënda shëndetësore.
6. Hapjen e kutisë së ankesave një herë në muaj nga ana e përfaqësuesve të Drejtorisë Rajonale të SHSSH-së, Tiranë dhe të Bashkisë Kavajë.

Në përputhje me nenin 22, të Ligjit Nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, ku thuhet se,

“Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, duhet ta shqyrtojnë rekomandimin dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit”,

Lutemi ta shqyrtoni dhe të na vini në dijeni për qëndrimin ndaj rekomandimeve sipas kompetencave tuaja ligjore.

Duke besuar në bashkëpunimin Tuaj,

K O M I S I O N E R

Ermir KAPEDANI